

# Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjeve Parimet ndërkombëtare dhe mbikëqyrja në Kosovë

---

Prishtinë, shtator 2020





# Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjeve

## Parimet ndërkombëtare dhe mbikëqyrja në Kosovë

---

Prishtinë, shtator 2020

**Ky publikim është përgatitur me përkrahjen e zyrës Konrad-Adenauer-Stiftung në Prishtinë.**

Përgatitur nga:



Copyright © 2020. Democracy Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjete elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+. Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të Konrad Adenauer Stiftung.

# Përmbajtja

---

<b>SHKURTESAT</b>	<b>6</b>
<b>1. HYRJE</b>	<b>7</b>
<b>2. PARIMET E MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË LIGJEVE</b>	<b>8</b>
<b>3. PRIRJET NDËRKOMBËTARE TË KOMISIONEVE PARLAMENTARE MBI MBIKËQYRJEN POST-LEGJISLATIVE</b>	<b>11</b>
3.1 Mbikëqyrja e komisioneve parlamentare sipas katër formave (pasiv, joformal, formal dhe i pavarur) në vendet evropiane	11
3.2 Mbikëqyrja Post-Legjislative nga komisionet për çështje evropiane në parlamentet kombëtare	12
Raste studimi të vendeve anëtare dhe atyre aspiruese për në BE	12
Lituania - Roli i “Seimas” (parlamentit) drejtë integritimit në BE	13
Moldavia – Sfidat parlamentare për anëtarësim në BE	15
Mali i Zi – Funkcionaliteti i Komisionit për Integrim Evropian në parlamentin malazez	17
<b>4. ZBATIMI I ROLIT MBIKËQYRËS TË KUVENDIT TË KOSOVËS PËRMES MBIKËQYRJES POST-LEGJISLATIVE</b>	<b>19</b>
4.1 Korniza ligjore	19
4.2 Ushtrimi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nga kuvendi	20
4.3 Procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nga qeveria	22
4.4 Sfidat e Kuvendit në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve	24
4.5 Analiza e raporteve të PLS-së	26
<b>5. REKOMANDIMET</b>	<b>29</b>
<b>SHTOJCA 1: PARIMET E MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË LIGJEVE NGA PARLAMENTET TË HARTUARA NGA WFD</b>	<b>30</b>
<b>SHTOJCA 2: LISTA E RAPORTEVE EX-POST TË LEGJISLACIONIT TË MIRATUAR DHE AKTEVE QË JANË NË PROGRAM PËR VLERËSIM PËR VITIN 2020</b>	<b>32</b>
<b>BIBLIOGRAFIA</b>	<b>34</b>

## Shkurtesat

---

<b>CFAE</b>	Komisioni për Punë të Jashtme dhe Integrim Evropian i Parlamentit të Moldavisë
<b>COSAC</b>	Konferenca e Komisioneve Parlamentare për çështjet parlamentare të Bashkimit Evropian
<b>GIZ</b>	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
<b>JPSG</b>	Grupi i Përbashkët i Mbikëqyrjes Parlamentare
<b>KOMF</b>	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
<b>MAShT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>OJQ</b>	Organizata Joqeveritare
<b>PLS</b>	Mbikëqyrje Post-Legjislative
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>WFD</b>	Fondacioni i Uestminsterit për Demokraci

# 1. Hyrje

---

Në Kosovë tashmë është bërë klishe fraza se “kemi ligje të mira, por zbatimi i tyre në praktikë është i dobët”. Mirëpo, pavarësisht që mund ta quajmë edhe klishe, kjo frazë paraqet një të vërtetë të hidhur. Sipas të dhënave në Gazetën Zyrtare të Kosovës, aktualisht në fuqi janë 472 ligje. Që një projektligj të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet të kalojë nëpër disa filtra, një prej të cilave është edhe përputhshmëria me legjislacionin e BE-së (*Acquis communautaire*). Përveç kësaj, shumë prej këtyre ligjeve të miratuara, në fazën hartuese janë përkrahur nga institucione ndërkombëtare përmes ekspertëve të tyre, që ka qenë një garant i hartimit të ligjeve cilësore. Natyrisht nuk përjashtohen rastet kur një pjesë e legjislacionit në Kosovë ka edhe mangësi serioze, si bie fjala mospërputhshmëria me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (*rasti i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ku disa prej kritereve të certifikimit të kandidatëve ishin në kundërshtim me kushtetutën, konstatim ky i Gjykatës Supreme*), apo kur ligjet bien në kundërshtim me njëri-tjetrin (*shembull: Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme me Ligjin për Barazi Gjinore, sa i përket përfaqësimit të grave në institucione publike*). Kemi edhe raste kur ligjet ndryshohen shpesh, siç është ai i Prokurimit Publik, i cili është ndryshuar plot shtatë herë). Që ligjet “e mira” edhe të zbatohen në praktikë, duhet të ketë shtim të aktiviteteve të kuvendit, duke filluar nga monitorimi i zbatimit të tyre, identifikimi i defekteve në ligje, mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit sekondar, si dhe thirrja në përgjegjësi e institucioneve që nuk i zbatojnë.

Qëllimi i këtij punimi është pikërisht vlerësimi i punës së kuvendit në raport me mbikëqyrjen e ligjeve. Institucioni më i lartë legjislativ në vend vazhdimisht është kritikuar në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, e atë për performancë të dobët në rolin që ka për mbikëqyrje. Fillimisht është analizuar korniza ligjore që i mundëson kuvendit mandatin për mbikëqyrjen e ligjeve, për të parë nëse ka zbrazëti në këtë drejtim, pastaj janë krahasuar legjislatura të ndryshme nga viti 2008. Në fund, janë analizuar

raportet e miratuara në kuvend, raporte këto të nxjerra nga mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, si dhe nëse janë identifikuar dispozitat që nuk kanë gjetur zbatim në praktikë.

Në këtë punim janë zbërthyer edhe praktikat ndërkombëtare të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, respektivisht të përpjekjeve që po bëhen nga parlamentet me demokraci të zhvilluar, të parlamenteve të vendeve fqinje dhe atyre që aspirojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE). Këto përpjekje kanë për qëllim që ta avancojnë rolin e tyre mbikëqyrës ndaj ekzekutivit, pikërisht përmes mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Në këtë punim kemi paraqitur edhe parimet dhe standardet të cilat janë në zhvillim e sipër nga organizata ndërkombëtare siç është WFD. Këto parime paraqesin shtylla bazë përmes së cilave mund të kryhet një mbikëqyrje efektive e zbatimit të ligjeve, llojet e ligjeve të cilat duhet të kenë prioritet, metodologjia që duhet të përdoret, koha e përshtatshme për të kryer aktivitete mbikëqyrëse, e deri te konsultimet me aktorët, komunikimi me mediat dhe faza përcjellëse pas përfundimit të mbikëqyrjes.

## 2. Parimet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve

Në vendet me sisteme parlamentare të qeverisjes, kuvendi ka tri role kryesore: i) të hartojë ligje; ii) të mbikëqyrë punën e qeverisë; dhe iii) të përfaqësojë qytetarët. Hartimi i ligjeve të cilat plotësojnë nevojat e shoqërisë, përkatësisht qytetarëve të vendit, është një proces i gjatë që kalon nëpër disa faza dhe kërkon përfshirjen e shumë palëve të interesit. Përgjegjësia dhe roli i kuvendit nuk përfundon me aktin e miratimit formal të një ligji. Ndër të tjera, ky institucion sigurohet që i njëjti ligj po zbatohet nga institucionet përgjegjëse dhe po i arrin objektivat. Përveç kësaj, kuvendi mbikëqyrë miratimin e legjislacionit sekondar, si dhe identifikon mangësitë eventuale me qëllim të plotësimit të ligjit.

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve është një element kyç për rritjen e përgjegjshmërisë së qeverisë. Prioriteti i këtij procesi qëndron në zbatimin e ligjit, gjë e cila ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e mirëqenies shoqërore. Në këtë drejtim, parlamentet nga e gjithë bota po e cilësojnë si pikë të rëndësishme pjesën e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, duke krijuar kështu hapa specifike për ta bërë një gjë të tillë. Mbikëqyrja Post-Legjislative (PLS) mund të konsiderohet si një koncept më i gjerë i përbërë nga dy dimensione: fillimisht duhet ditur nëse dispozitat ligjore kanë hyrë në fuqi, dhe pastaj nëse objektivat e synuara të politikës janë përmbushur.

Përfitimet e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve:

- 1) Forcimi i qeverisjes demokratike, që nënkupton zbatim të legjislacionit në përputhje me parimet e sundimit të ligjit dhe sigurisë juridike;
- 2) Identifikimi paraprak i efekteve të disfavorshme dhe parandalimi i tyre;

- 3) Mundësia për vlerësim të vazhdueshëm se si ligjet i përgjigjen çështjeve që synojnë t'i rregullojnë<sup>1</sup>.

Në vijim do t'ju kushtojmë vëmendje parimeve të PLS-së, të cilat janë hartuar nga Fondacioni i Uestminsterit për Demokraci (WFD) si:

- **Mandati** (Pse?)
- **Fusha** (Çfarë?)
- **Pjesëmarrësit** (Kush?)
- **Procesi** (Si?)
- **Koha** (Kur?)

**Mandati:** Parlamentet shfrytëzojnë resurse të shumta humane dhe financiare për hartimin e legjislacionit. Nuk është e rrallë që procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit të neglizhohet. Zbatimi është një çështje komplekse që varet në mobilizimin e resurseve dhe aktorëve të ndryshëm, si dhe nga koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet palëve të përfshira në këtë proces. Janë disa faktorë që ndikojnë në mbarëvajtjen e procesit të zbatimit të legjislacionit, si: ndryshimi i fakteve në terren, devijimi i burimeve, devijimi i qëllimeve, rezistenca nga palët e interesuara dhe ndryshimet e ligjeve që prekin fusha të ndërlidhura. Zbatimi i legjislacionit dhe politikave gjithashtu mund të dëmtohet nga asimetria e pushtetit, përjashtimi, kapja e shtetit dhe klientelizmi.

1 Westminster Foundation for Democracy (WTF), Post-Legislative Scrutiny in the Americas, Ecuador, mars 2019. Qasur në: <http://www.parlAmericas.org/uploads/documents/2019-03-06%20draft%20Comparative%20Study%20on%20PLS%20in%20Americas%20-%20English%20Version.pdf>.





Në vendet me sisteme parlamentare të qeverisjes,  
kuvendi ka tri role kryesore:

- 1) të hartojë ligje
- 2) të mbikëqyrë punën e qeverisë
- 3) të përfaqësojë qytetarët.

Pavarësisht këtyre sfidave, ekzistojnë katër arsye thelbësore që parlamentet duhet ta priorizojnë monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të legjislacionit:

1. për t'u siguruar qeverisja demokratike dhe aplikimi i parimeve të ligjshmërisë dhe sigurisë juridike;
2. për t'u lehtësuar identifikimi me kohë i efekteve të disfavorshme të ligjeve të reja;
3. për ta përmirësuar fokusin në kuptim të zbatimit dhe shpërndarjes së qëllimeve të politikave përkatëse; si dhe
4. për t'i identifikuar dhe shpërndarë praktikatat e mira.<sup>2</sup>

Në një kuptim më të gjerë, kontrolli apo mbikëqyrja post-legjislative shikon ndikimin e legjislacionit, pra nëse objektivat e synuara të ligjit janë përmbushur dhe sa realisht kanë qenë efektive.

**Fusha:** Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve është një koncept i gjerë dhe mund të nënkuptojë gjëra të ndryshme për parlamentet dhe palët e interesuara. Në një interpretim më të ngushtë, kontrolli post-legjislative mbikëqyrë nëse dispozitat e ligjeve të

miratuara kanë hyrë në fuqi, nëse gjykatat kanë interpretuar ligjin dhe se si praktikuesit e ligjit dhe qytetarët e kanë aplikuar të njëjtin. Janë dy dimensionet e kontrollit post-legjislative: 1) të vlerësojë miratimin e ligjit dhe hyrjen në fuqi nga aspekti teknik; dhe 2) t'i vlerësojë rezultatet e synuara. Rekomandohet që parlamentet t'i kryejnë të dy këto forma të kontrollit post-legjislative.

**Pjesëmarrësit:** Roli i parlamentit është ta konsiderojë shqyrtimin post-legjislative, si proces të përhershëm. Ky shqyrtim është gjithëpërfshirës, ku të gjitha partitë politike kanë mundësi të marrin pjesë. Në këtë shqyrtim, do të ishte më mirë sikur parlamentet të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse. Çështje tjera me rëndësi janë: mbledhja e informatave, posedimi i dokumenteve në gjuhë tjera dhe shumë procese të kësaj natyre.

**Procesi:** Për të ditur më shumë rreth funksionimit të proceseve të PLS-ve, së pari duhet të dimë mbarëvajtjen e secilës fazë dhe çka përfshijnë ato gjatë implementimit të një legjislacioni si ky. Pra, ekzistojnë tri faza të tilla, **procesi para fazës së hetimit** - përfshin identifikimin dhe rishikimin e legjislacionit, si p.sh: legjislacionin primar, legjislacionin sekondar, raportet vjetore administrative, raportet e kaluara të komisioneve të përzgjedhura për entitetin, dokumentet e buxhetit, planin strategjik të biznesit, si dhe publikimet akademike. Në fazën e dytë apo **fazën e hetimit**, anëtarët kanë liri të bëjnë pyetje që përfshijnë

2 Westminster Foundation for Democracy (WTF), Principles of Post-Legislative Scrutiny by Parliaments, London, janar 2018. Qasur në: <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2018/07/Principles-of-Post-Legislative-Scrutiny-by-Parliaments.pdf>.



Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve është një element kyç për rritjen e përgjegjshmërisë së **qeverisë**. Prioriteti i këtij procesi qëndron në zbatimin e **ligjit**, gjë e cila ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e **mirëqenies shoqërore**.

shqyrtimin e *çështjeve përkatëse të legjislacionit*. *Këto pyetje mund të përgatiten nga vetë anëtarët*. Ndërkaq, faza e tretë është **faza e raportimit**, ku shpalosen të gjeturat dhe identifikohet ndikimi i një ligji në ligjet tjera për *çështje të caktuara*<sup>3</sup>.

Është e udhës që institucionet ligjvënëse, aktivitetet e tyre në fushën e mbikëqyrjes, t'i përfshijnë në rregulloret e punës. Një hap i tillë ofron qartësi për PLS. Aftësia e parlamentit për të marrë, integruar dhe përpunuar të dhëna qeveritare dhe të tjera në dispozicion ka rëndësi bazike. Prandaj, ndërlidhja me bazën e të dhënave qeveritare, përfshirja e të dhënave të hapura dhe krijimi i një aparati administrativ për mbështetje parlamentare janë parakushtet për zbatim efikas të PLS-it. Kështu, më së shumti do të duhej të përqendrohej në miratimin dhe ndikimin e ligjeve, pra se si jetësohen në praktikë. Herë pas here duhet shtruar pyetja se sa ka ndikuar PLS në arritjen e objektivave të dhëna. Sugjerohet që objektivat e kontrollit të PLS të arrihen në bazë të ndikimit ligjor, politik, shoqëror dhe ekonomik, ku duhet të shikohet implementimi i legjislacionit parësor dhe sekondar, nëse objektivat politike janë përmbushur, nëse ka vështirësi në zbatim, nëse ligji

është i kuptueshëm nga palët që preken dhe palët tjera të interesuara, a ka trajtim në aspektin gjinor, si dhe nëse është ende i nevojshëm si ligj<sup>4</sup>.

**Koha:** Afati kohor i procesit varet nga disa faktorë si: kompleksiteti i objektivave, vëllimi dhe fushëveprimi i vlerësimit, organizimi, shpeshësia e takimeve, plani i punës, burimet, cilësia e analizave, ekspertët, etj. Duke i pasur parasysh tërë faktorët e lartpërmendur, mund të thuhet se është vështirë të përcaktohet një afat kohor i përgjithshëm për shqyrtimin e të gjitha ligjeve. Megjithatë, një afat solid dhe i rekomandueshëm do të ishte një periudhë prej të paktën tri vitesh. Procesi i ri i modelit të vlerësimit të ndikimit kërkon që politikëbërësit që nga fillimi i zhvillimit të politikave të ofrojnë një përmbledhje të shkurtër të objektivave dhe efekteve të synuara.

Si përfundim mund të themi që PLS mund të sjellë të mira të shumta, me ç'rast duhet të bëhen përpjekje shtesë që qytetarët të përfitojnë nga efekti i saj, por në të njëjtën kohë të kontribuojnë për zhvillimin e legjislacionit.

3 Westminster Foundation for Democracy (WTF), Post-Legislative Scrutiny in the Americas, Ecuador, mars 2019. Qasur në: <http://www.parlAmericas.org/uploads/documents/2019-03-06%20draft%20Comparative%20Study%20on%20PLS%20in%20Americas%20-%20English%20Version.pdf>.

4 Westminster Foundation for Democracy (WTF), Post-Legislative Scrutiny, Guide for Parliaments, London, nëntor 2017. Qasur në: [https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2018/07/WFD\\_Manual-on-Post-Legislative-Scrutiny.pdf](https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2018/07/WFD_Manual-on-Post-Legislative-Scrutiny.pdf).

# 3. Prirjet ndërkombëtare të komisioneve parlamentare mbi Mbikëqyrjen Post-Legjislative

Barra e Mbikëqyrjes Post-Legjislative bie mbi komisionet parlamentare të cilat kanë mekanizma për monitorimin e implementimit të ligjeve, ecurinë dhe funksionalitetin e tyre në secilën fazë.

Këtë mbikëqyrje disa parlamente ua kanë bart si detyrë operative departamenteve të shpërndara në komisionet përkatëse, ndërsa ka edhe disa të tjera që kanë krijuar komisione të veçanta që do të trajtojnë Mbikëqyrjen Post-Legjislative. Në Liban, kryetari i parlamentit kohët e fundit ka themeluar një komision të posaçëm për këtë gjë. Ky komision nuk është i përhershëm dhe për këtë arsye mandati do t'i skadojë në fund të mandatit parlamentar, megjithëse kryetari i ri i parlamentit mund ta rikthejë sërish në legjislaturën tjetër<sup>5</sup>.

Në vazhdim do të shohim të përkrahura, disa nga teknikat dhe format që përdorin parlamentet e huaja rreth PLS-së, pra do të ndalemi të disa vende evropiane. Tutje, fokusin do ta kemi te komisionet që merren me çështjet evropiane, gjegjësisht integruese në BE. Prandaj si raste studimi, kemi Lituaninë, aktualisht anëtare, Moldavinë si shtet që nuk është pjesë e BE-së, por është pjesë e disa marrëveshjeve, si dhe Malin e Zi, candidate për t'iu bashkuar BE-së.

## 3.1 Mbikëqyrja e komisioneve parlamentare sipas katër formave (pasiv, joformal, formal dhe i pavarur) në vendet evropiane

Në Evropë, Parlamenti i BE-së sidomos me Traktatin e Lisbonës ka shtyrë përpara funksionimin efektiv të parlamenteve kombëtare të vendeve anëtare dhe atyre që synojnë anëtarësimin në BE drejt mbikëqyrjes së një niveli më të lartë të ligjeve dhe në përgjithësi proceseve vendimmarrëse. Një forum i ri ndërparlamentar, Grupi i Përbashkët i Mbikëqyrjes Parlamentare (JPSG), aktualisht është duke u bazuar në rregulloren e rishikuar të Europol të vitit 2016. Qëllimi i tij është t'i monitorojë politikisht aktivitetet e Europol-it në përmbushjen e misionit të tij, sa i përket ndikimit të veprimtarive të tilla mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut<sup>6</sup>. Parlamentet në Evropë kanë qasje të ndryshme lidhur me mbikëqyrjen parlamentare. Në terme të gjera, këto parlamente përdorin strategjinë administrative, që ka të bëjë me mbledhjen e dokumentacionit dhe fazën vlerësuese dhe strategjinë politike, që bën ndërlidhjen dhe bashkëpunimin e parlamentit me qeverinë, dhe ndikimin e kësaj të fundit në PLS.

Janë katër forma përmes së cilave do të shohim se si disa nga parlamentet në Evropë e kryejnë mbikëqyrjen e ligjeve.

**1. Mbikëqyrësit pasivë** mbështetjen e kanë përmes trupave që derivojnë nga qeveria dhe agjencitë e jashtme, e me pak ndihmë nga strukturat e parlamentit. Mund të nënvizojmë se parlamenti belg përdorë një praktikë të tillë.

5 Westminster Foundation for Democracy (WTF), "Post-Legislative Scrutiny Comparative study of practices of Post-Legislative Scrutiny in selected parliaments and the rationale for its place in democracy assistance", Londër, 2017, faqe8. Qasur në: <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2018/07/Comparative-Study-PLS-WEB.pdf>.

6 Article 51(2) of Regulation (EU) No 2016/794 on Europol, faqe 39. Qasur në: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/583126/IPOL\\_STU\(2017\)583126\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/583126/IPOL_STU(2017)583126_EN.pdf).

Aty parlamenti e mbështet procesin me legjislacionin e duhur, por ofron numër të limituar të stafit.

**2. Mbikëqyrësit joformal** fokusohen në strukturat aktuale të vetë parlamentit që kanë përgjegjësi për zbatimin e analizave legjislative dhe ndikimit të tyre. Gjermania dhe Italia janë shembuj ku barra bie mbi komisionin përkatës parlamentar. Duhet cekur se, Gjermania edhe pse e orientuar shumë pak kah mbikëqyrja pasive, është vërejtur një rritje e ndikimit të së njëjtës. Ndoshta kjo ndodh meqë, veç ekziston një lloj mbështetjeje paraprake që ka të bëjë me informacionet që dalin nga qeveria lidhur me zbatimin dhe ndikimin e legjislacionit, e parlamenti nga ana tjetër ka kapacitet të kufizuar në këtë drejtim<sup>7</sup>. Ndërsa në parlamentin Italian ka një qasje administrative, ku janë formuar dy njësi ad-hoc në Dhomën e Lartë dhe senatin italian.

**3. Mbikëqyrësit formal** kanë departamente dhe procedura specifike për PLS-në që veprojnë sistematikisht, e që dalin pastaj me të gjetura dhe përfundime. Parlamenti suedez dhe francez përqafojnë teknika të tilla, që i bëjnë formal dhe duhet cekur se të dyja këto vende bazë mbështetëse për gjithë këtë e kanë kushtetutën. Suedezët, nenet kushtetuese i zbatojnë përmes legjislacionit dhe rregullave procedurale të parlamentit. Në anën tjetër, francezët veprojnë po një lloj, ku mbikëqyrja përfshinë verifikimin zyrtar të zbatimit të ligjit dhe efektet e prodhuara.

**4. Mbikëqyrësit e pavarur** mbikëqyrjen e kanë në një nivel të lartë institucional, duke filluar nga parlamenti, e të cilat përcjellën me rekomandime dhe të gjetura. Komisionet parlamentare vendosin cilat ligje duhet të mbikëqyren me një qasje proaktive dhe transparente. Vendet si Britania e Madhe dhe Zvicra e përdorin këtë metodë, ku PLS është njëra ndër detyrat kryesore të secilit komision. Diçka që vlen të theksohet te Britania e Madhe, është çështja e angazhimit të një numri të madh ekspertësh të fushave përkatëse që angazhohen në sektorë të

ndryshëm. Vlen të përmendet që këtu po ceken vetëm parlamentet, megjithëse shumica e këtyre të fundit bashkëpunojnë me institucione të tjera të mbikëqyrjes së pavarur, qoftë përmes 'zyrtarëve parlamentarë' (në parlamentet e tipit Westminster) ose përmes 'agjentëve parlamentarë' (siç është Zyra Kombëtare e Auditimit në Suedi). Shpesh puna e tyre është e mirëseardhur nga parlamentet<sup>8</sup>. Po ashtu, përmes punës së komisioneve me të gjeturat dhe rekomandimet, qeverisë britanike i kërkohet edhe përgjegjësi. Njësoj sikurse Britania, vepron edhe Zvicra, të cilat i kushtojnë rëndësi vlerësimit përfundimtar të analizës, prandaj edhe janë vendet e para që kanë futur nene në kushtetutat e tyre, nene këto që ndërlidhen me politikën vlerësimit legjislativ.

### 3.2 Mbikëqyrja Post-Legjislative nga komisionet për çështje evropiane në parlamentet kombëtare

#### Raste studimi të vendeve anëtare dhe atyre aspiruese për në BE

Varësisht prapavijës historike e politike të secilit vend, edhe gjendja e mbikëqyrjes së ligjeve dallon dhe është në faza dhe nivele të ndryshme në secilin prej tyre.

Lidhur me këtë, vetë BE, prej vitit 1989 mban Konferencën e Komisioneve Parlamentare për Çështjet Parlamentare të Bashkimit Evropian (COSAC), e atë dy herë në vit, ku marrin pjesë eurodeputetë dhe deputetë të parlamenteve kombëtare (gjashtë nga secili shtet) që kryesisht vijnë nga komisionet përgjegjëse për çështjet që kanë bëjnë me BE-në.

Parë nga ana e vetë punës së BE-së rreth kësaj çështjeje, vërejmë se në Traktatin e Lisbonës, i është dhënë më shumë hapësirë aktiviteteve dhe funksionit më efektiv të parlamenteve kombëtare

7 Westminster Foundation for Democracy (WTF), Franklin De Vrieze, "Post-Legislative Scrutiny in Europe", Londër 2020, faqe 25. Qasur në: [https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/02/WFD\\_DeVrieze\\_2020\\_PLSinEurope.pdf](https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/02/WFD_DeVrieze_2020_PLSinEurope.pdf).

8 Westminster Foundation for Democracy (WTF), Franklin De Vrieze, "Post-Legislative Scrutiny in Europe", Londër 2020, faqe 16. Qasur në: [https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/02/WFD\\_DeVrieze\\_2020\\_PLSinEurope.pdf](https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/02/WFD_DeVrieze_2020_PLSinEurope.pdf).

të vendeve anëtare dhe jo vetëm. Njëra ndër nenet përcakton se, "Parlamentet kombëtare kontribuojnë në mënyrë aktive në funksionimin e mirë të BE-së: përmes informimit të institucioneve të saj dhe përmes hartimit të akteve legislative të BE-së që përcjellën në përputhshmëri me rolin e parlamenteve kombëtare në Evropë"<sup>9</sup>. Lidhur me politikën integruese, BE nxit parlamentet kombëtare t'i kushtojnë rëndësi legjislativitetit që do t'ua mundësonte edhe integrimin më shpejt. Prandaj, ky raport rekomandon fuqishëm ngritjen e një komisioni për integrim evropian. Komisioni përkatës mund të jetë vazhdimësi e një komisioni aktual për politikë të jashtme dhe integrim evropian, por ndoshta edhe duke përfshirë përfaqësues nga komisionet e tjera të përhershme<sup>10</sup>.

### Lituania - Roli i "Seimas" (parlamentit) drejtë integritit në BE

Rasti i Lituaniës tregon se kompetencat për t'u marrë me çështjet evropiane janë të ndara ndërmjet qeverisë dhe kuvendit, madje mund të themi se qeveria e ka rolin vendimtar. Përpjekjet e bëra gjatë viteve të '90-ta në përafrimin me e BE-në, në përmbushjen e marrëveshjeve dhe kritereve të parashtruara nga Këshilli i Evropës ishin çështjet kryesore. Përgjegjësia për shpejtimin e procesit të integritit, që përfundimisht ndodhi në 2014-në, i kishte rënë parlamentit lituan së bashku me qeverinë.

Një pjesë e Kushtetutës së Lituaniës, kushtetutë kjo e vitit 1992, në pikën 3 thekson se: "Komisioni i Seimas për Çështjet Evropiane dhe Komisioni i Seimas për Punë të Jashtme, sipas procedurës së vendosur nga Statuti i Seimas, mund t'i paraqesin qeverisë mendimin në lidhje me propozimet për t'i miratuar aktet e BE-së. Qeveria

pastaj do t'i vlerësojë rekomandimet ose mendimet e paraqitura nga Seimas dhe komitetet e saja dhe do ta informojë Seimas për zbatimin e tyre sipas procedurës së përcaktuar me akte ligjore"<sup>11</sup>.

Komisioni për Çështje Evropiane me statut të parlamentit u themelua në shtator të 1997-së, duke e zëvendësuar Komisionin për Reforma Ekonomike dhe Integrim. Sot, ky komision ka 23 anëtarë në përbërje, aty kërkohet pjesëmarrje reprezentative si nga partitë por edhe nga sektorët tjerë, e që e bën komisionin me numrin më të madh të anëtarëve. Neni 44 i Statutit të Seimas (Parlamentit) lituan që e tregon formimin e komisionit, ndër të tjera shpjegon se i njëjti nuk duhet të ketë më pak se 15 dhe më shumë se 25 anëtarë në përbërje<sup>12</sup>. Tutje theksohet se, deputeti që merret me çështjet evropiane, merr për detyrë të udhëheqë komisionin.

Prandaj, ky parlament para integritit në BE, por edhe sot monitoron edhe aktivitetet e qeverisë, kjo e fundit në fillim kishte për detyrë të informonte parlamentin dhe komisionet për legjislativitetin, si dhe aktet që duhej të harmonizoheshin. Ky shtet kishte themeluar edhe Zyrën e Informacionit Evropian për qëllim asistence qoftë me informacione e dokumente lidhur me procesin integrues, por më e rëndësishmja me kërkesat dhe detyrat që parashtroheshin. Çështjen e integritit, qeveria dhe parlamenti lituan e kanë trajtuar me seriozitet, duke i kryer detyrat e shtëpisë që ua kishte dhënë BE-ja<sup>13</sup>. Sipas studiuesit lituan, Mindaugas Jurkynas, "Seimas me aq dëshirë tregonte "evropianizimin politik", sa që disa parlamentarë votuan për dokumentin e pandryshuar pa e lexuar fare. Ndërkaq, debatet politike rreth Kushtetutës së Lituaniës ishin praktikisht joekzistente"<sup>14</sup>.

9 Official Journal of the European Union. "Treaty of Lisbon amending the Treaty on European Union and the Treaty establishing the European Community" (2007/C 306/01), Article 8 C, faqe 15. Qasur në: [http://publications.europa.eu/resource/cellar/688a7a98-3110-4ffe-a6b3-8972d8445325.0007.01/DOC\\_19](http://publications.europa.eu/resource/cellar/688a7a98-3110-4ffe-a6b3-8972d8445325.0007.01/DOC_19).

10 UNDP Moldova. "Role of Parliament in European Integration", qershor 2011, faqe 25. Qasur në: <https://agora-parl.org/sites/default/files/UNDP%20Moldova%20Final%20Report%20on%20Parliament%20and%20European%20Integration.pdf>.

11 The Constitution of the Republic of Lithuania. Qasur në: <https://www.lrs.lt/home/Konstitucija/Constitution.htm>.

12 Seimas of the Republic of Lithuania, 1994, Vilnius. Qasur në: [https://publicofficialsfinancialdisclosure.worldbank.org/sites/fdl/files/assets/law-library-files/Lithuania\\_Seimas%20Statute\\_1994\\_amended%20through%20November%202009\\_EN.pdf](https://publicofficialsfinancialdisclosure.worldbank.org/sites/fdl/files/assets/law-library-files/Lithuania_Seimas%20Statute_1994_amended%20through%20November%202009_EN.pdf).

13 Official site of Parliament of Lithuania, "The Seimas and the EU". Qasur në: [https://www.lrs.lt/sip/portal.show?p\\_r=35664&p\\_k=2&p\\_t=250052](https://www.lrs.lt/sip/portal.show?p_r=35664&p_k=2&p_t=250052).

14 Jurkynas, M, "Lithuania- Life in PostCommunist Eastern Europe after EU Membership: Happy Ever After?", Oxon, Routledge, 2012, faqe 124.

Meqë barra e zbatimit binte mbi qeverinë, *Seimas* dhe komisioni nuk kishin përfshirë hisedarë dytësorë në këtë mes. Për shembull raporti me shoqërinë civile nuk ishte aq i kënaqshëm pasi kishte fragmentime se nuk kishte përfshirje të mjaftueshme të saj, ndonëse me rregullore dhe kushtetutë, parashihet pjesëmarrja në hartimin e projektligjeve. Komisioni kryesor duhet të dërgojë projektligjin në të gjitha institucionet shtetërore të interesuara dhe nëse është e nevojshme, në organizatat publike, qeveritë lokale, partitë politike dhe organizatat tjera, në mënyrë që të njëjtat të kenë mundësi t'i dërgojnë komentet e tyre. Bordi i *Seimas* ose Asambleja e Pleqve mund të përcaktojë se në cilat institucione ose persona duhet të dërgohet drafti<sup>15</sup>. Diskutimi, sidomos i projektligjeve që kërkoheshin të amendamentoheshin për t'u integruar, ishte i domosdoshëm. Në fund, *Seimas*, në seancë plenare, vendos nëse duhet të miratohet çdo nen i ligjit, nëse duhet të aprovohen ndryshimet që janë paraqitur nga personat që kanë të drejtë të iniciativës legislative, por jo më vonë se 24 orë para fillimit të seancës së *Seimas*, dhe më në fund - nëse duhet të miratohet i gjithë ligji<sup>16</sup>.

### Kontrolli i subsidiaritetit<sup>17</sup>

Sot raporti i Lituaniës me BE-në është në fazën e implementimi të kërkesave dhe politikave që parashtrohen nga ta. Për shembull në vitin 2015, Komisionit për Çështje Evropiane ju dha një listë prej gjashtë prioritetesh për një afat pesëvjeçar për t'i futur në agjendën e tyre, prioritete këto që kanë të bëjnë me energjinë, transportin, infrastrukturën, etj. Sidoqoftë, rolin dikur para integritimit, por edhe sot në mbajtjen dhe forcimin e marrëdhënies me BE-në, e mbartë qeveria lituane, konkretisht ministria përkatëse. Mirëpo, roli i komisionit dhe i *Seimas* në përgjithësi, sidomos në hartimin e legjislacionit, ka qenë bazik dhe në këtë drejtim ka dalur si shumë i suksesshëm.

#### ➤ Pranimi i projektaktit legjislativ të BE-së

➤ Propozim-legjislacioni i BE-së me vendim të Komisionit për Çështje Evropiane i përcillet komiteteve të specializuara brenda kompetencave të tij

➤ Komiteti i specializuar i paraqet Komisionit për Çështjet Evropiane konkluzionin nëse drafti përputhet me parimin e subsidiaritetit

➤ Nëse projektligji është duke shkelur parimin e subsidiaritetit, Komisioni për Çështje Evropiane e referon atë për debat në seancën plenare të Parlamentit

15 Robert Schuman Centre for Advanced Studies, EU Member States' Consultation with Civil Society on European Policy Matters, Florence, October 2011, faqe 124. Qasur në: [https://cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/19357/eudo\\_report\\_2011\\_04.pdf?sequence=1](https://cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/19357/eudo_report_2011_04.pdf?sequence=1).

16 Public Relations Unit of the Communications Department of the Seimas of the Republic of Lithuania, "Seimas (parliament) of the Republic of Lithuania", Vilnius, faqe 37. Qasur më: [https://www3.lrs.lt/leidiniai/Seimas\\_kn\\_en.pdf](https://www3.lrs.lt/leidiniai/Seimas_kn_en.pdf).

17 Source of content: "Seimas, Scrutiny of the Eu Affairs in the Seimas of the Republic of Lithuania", faqe 3.

## **Moldavia – Sfidat parlamentare për anëtarësim në BE**

Parlamenti i Moldavisë si dhe i gjithë shteti, integrimin evropian e ka njërin ndër prioritetet kryesore. Përpjekjet për anëtarësim në BE i mbështet kryesisht në planin e veprimit trevjeçar të ENP-së (European Neighborhood Policy) – Politikën Evropiane të Fqinjësisë. Ndër të tjera ENP e vlerëson rolin e parlamentit si një mundësi përafruese me vendet e tjera anëtare dhe fqinjët. Ndërsa, mekanizma ndihmues janë arterie drejt këtij qëllimi, ndër to edhe Asambleja Parlamentare EuroNest. Kështu, Asambleja Parlamentare e EuroNest është krijuar si një asamble e përbashkët e Parlamentit Evropian dhe vendeve të partneritetit lindor, përfshirë Moldavinë, si dhe komisionet e përbashkëta parlamentare ndërmjet Parlamentit Evropian dhe parlamenteve të vendeve partnere, si forume të rëndësishme për dialog dhe rritje të mirëkuptimit reciprok midis vendimmarrësve<sup>18</sup>.

Komisioni për Marrëdhënie të Jashtme dhe Integrim Evropian është një mekanizëm funksional i këtij parlamenti që merret direkt me çështjet përafruese me BE-në. Veçanërisht, parlamenti merret me mbikëqyrjen e ligjeve që derivojnë nga ai. Komisioni për Punë të Jashtme dhe Integrim Evropian (CFAEI) detyrën kryesore e ka në dhënien e fjalës së fundit apo miratimit të punëve të komisioneve sektoriale varësisht fushave, njashtu përveç për së brendshmi, komisioni jep edhe miratime dhe opinione për traktate në rrafshin ndërkombëtar. Para kësaj, vetë parlamenti kishte marrë vendim, në korrik të vitit 2015, të formonte Këshillin Parlamentar për Integrim Evropian.

Ende Parlamenti i Moldavisë ka sfida rreth rolit të tij të limituar rreth integritit, kryesisht monitorues dhe shqyrtues, pasi barra më e madhe zbatuese bie mbi qeverinë e vendit, sidomos rreth dokumentacionit. Duhet cekur se në vitin 2011, kryeministri i Moldavisë

kishte emëruar koordinator për harmonizim të legjislacionit, që vinte nga Ministria e Drejtësisë, ministri kjo që kishte detyrën më të madhe sa i përket shqyrtimit të legjislacionit.

Sfidat janë edhe te mungesa e stafit të sekretariatit, e që përgjegjësitë e tyre janë administrative dhe teknike sa i përket dokumentacionit. Sfidat deri vonë kanë qenë edhe te moskoordinimi i stafit parlamentar dhe komisioneve mes vete, qoftë në takime apo në punën e tyre në përgjithësi. Aktualisht Komisioni për Politikë të Jashtme dhe Integrim Evropian në përbërje ka nëntë anëtarë dhe pesë konsulentë që vijnë nga sekretariati<sup>19</sup>. Takimet e komisionit bëhen një herë në javë, ministri thirret vetëm atëherë kur zbatohen planet e veprimit dhe obligimet karshi BE-së. Ndërkaq, roli i zyrtarëve qeveritarë nga ministria është që të raportojnë para komisionit dhe të përgjigjen në pyetjet e këtij të fundit. Në vitin 2016, në një hulumtim të bërë nga UNDP, siç mund ta shihni në tabelën 1, kjo organizatë e liston Moldavinë të fundit për nga stafi që angazhohet rreth integritit.

---

18 UNDP Moldova. "Role of Parliament in European Integration", qershor 2011, faqe 16. Qasur në: <https://agora-parl.org/sites/default/files/UNDP%20Moldova%20Final%20Report%20on%20Parliament%20and%20European%20Integration.pdf>.

---

19 Official site of the Parliament of the Republic of Moldova - Standing Committees, Committee on Foreign Policy and European Integration. Qasur në: <http://parlament.md/StructuraParlamentului/Comisiipermanente/tabid/84/CommissionId/4/language/en-US/Default.aspx>.

**TABELA 1.** Stafit parlamentar që punon në integrimin evropian (2016)<sup>20</sup>

Parlamenti	Numri i stafit jopolitik në sekretariat	Stafi i komisionit për integrim/ marrëdhënie në/ me BE	Stafi për harmonizim ligjor	Numri i përgjithshëm i stafit që punon në integrim/ marrëdhënie në/ me BE	Përqindja e stafit që punon në integrim/ marrëdhënie në/ me BE
Austria	380	9	7	16	4.2%
Republika Çeke	354	7	7	14	3.9%
Estonia	132	11	N/A	11	5.7%
Gjeorgjia	840	10	1	11	1.3%
<b>Kosova</b>	<b>168</b>	<b>4</b>	<b>9</b>	<b>13</b>	<b>7.7%</b>
Letonia	291	5	1	6	2.0%
Lituania	499	9	6	15	3.0%
Serbia	400	5	-	5	1.2%
Slllovakia	385	8	N/A	8	2.0%
Moldavia	375	4	-	4	1.0%

20 UNDP Moldova, "Functional and Institutional Analysis Findings and recommendations" prill 2016, faqe 28. Qasur në: [https://www.undp.org/content/dam/moldova/docs/Publications/Report\\_Functional%20Analyses%20of%20Secretariat%20of%20Parliament%202016.pdf](https://www.undp.org/content/dam/moldova/docs/Publications/Report_Functional%20Analyses%20of%20Secretariat%20of%20Parliament%202016.pdf).



Përmes Marrëveshjes Harmonizuese, BE i jep detyra parlamentit moldov për mbikëqyrje të legjislacionit. Kur jemi te mbikëqyrja, kornizat ligjore që dalin nga parlamenti duhet patjetër të ndërthurin edhe shoqërinë civile, sidomos në aspektin monitorues dhe mbështetës. Anëtarë të shoqërisë civile, me qëllim të integritimit sa më të shpejtë dhe përmirësimit të rrugës drejt BE-së, kishin rekomanduar që në parlament të formohet një komision që merret ekskluzivisht me çështjet e integritimit evropian, njësoj siç kishte bërë edhe aleati i tyre, Rumania. Një njësi legjislative, e parashikuar të krijohet si pjesë e sistemit të ri të posteve për Sekretariatit Parlamentar, duhet të ketë staf adekuat në mënyrë që t'ju sigurohen deputetëve produkte cilësore të hulumtimit legjislativ. E njëjta njësi është parashikuar të ndihmojë deputetët edhe në kryerjen e vlerësimeve periodike të ndikimit të ligjeve të përzgjedhura. Mirëpo, edhe pas disa viteve që nga nxjerrja e këtij rekomandimi, gjendja nuk ka ndryshuar sa i përket aspektit administrativ.

### **Mali i Zi – Funkcionaliteti i Komisionit për Integrim Evropian në parlamentin malazez**

Parlamenti malazez në vitin 2003 kishte formuar Komisionin për Integrim Evropian, pas tre vitesh ai ishte riemëruar duke u quajtur Komision për Marrëdhënie të Jashtme dhe Integrim Evropian. Duke qenë në të njëjtën linjë me kërkesat e BE-së dhe Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, ishte parë e nevojshme që ky komision të ndahej, dhe si përfundim nga maji i 2012-së, është themeluar Komisioni për Integrim Evropian<sup>21</sup>. Veprimtaria e tij shtrihet mbi këto pika:<sup>22</sup>

- të monitorojë negociatat e pranimit ndërmjet Malit të Zi dhe BE-së;
- të mbikëqyrë dhe vlerësojë rrjedhën e

negociatave dhe të nxjerrë mendime dhe udhëzime në emër të parlamentit, për pozicionet e përgatitura negociuese;

- t'i marrë në konsideratë informacionet mbi procesin e negociatave dhe të japë mendim për çështjet që lindin nga negociatat;
- të marrë në konsideratë dhe vlerësojë performancën e ekipit negociator.

Aktualisht në këtë legjislaturë, Komisioni për Integrim Evropian ka 12 anëtarë. Kontributi i komisionit shihet përmes veprimtarisë së Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit (SAPC). Megjithatë, motivi për të realizuar më shumë punë në kontrollin post-legjislativ është nxitur edhe nga reformat e kërkuara nga BE. Forcimi i rolit legjislativ dhe mbikëqyrës të parlamentit ishte një nga shtatë përparësitë kryesore që BE përcaktoi si parakusht për hapjen e negociatave për Malin e Zi, pasi u vlerësua se aftësia e përgjithshme e parlamentit për të siguruar mbikëqyrje të duhur të qeverisë ishte e kufizuar<sup>23</sup>.

Procesi i mbikëqyrjes së ligjeve, por edhe implementimit të tyre bëhet kryesisht përmes dëgjimeve konsultative, ku komisioni thërret zyrtarë nga qeveria që të raportojnë mbi implementimin e ligjit, ku më pas anëtarët e komisionit rekomandimet e dala nga dëgjimet dhe takimet i paraqesin në seancat plenare të parlamentit. Parlamenti gjithashtu është i detyruar të ndërmarrë masa konkrete. Për shembull, Ligji për Zgjedhjen e Këshilltarëve dhe Anëtarëve të Parlamentit kërkon që parlamenti ta bëjë vetë monitorimin e këtij ligji. Përveç bashkëpunimit qeveri dhe parlament, mund të përfshihen edhe organizatat joqeveritare apo oda ekonomike dhe autoritete tjera që kanë interes në një fushë të caktuar. Jashtë këtyre praktikave të përshkruara, është Komisioni për Barazi Gjinore që ka zbatuar deri tani ekzaminimin më gjithëpërfshirës dhe të hollësishëm të zbatimit të legjislacionit.

21 Official site of the Parliament of Montenegro: Assembly in the process of Montenegro's accession to the EU. Qasur në: [https://www.undp.org/content/dam/moldova/docs/Publications/Report\\_Functional%20Analyses%20of%20Secretariat%20of%20Parliament%202016.pdf](https://www.undp.org/content/dam/moldova/docs/Publications/Report_Functional%20Analyses%20of%20Secretariat%20of%20Parliament%202016.pdf).

22 Legislative Committee of the Parliament of Montenegro: Rules of Procedure, Committee on European Integration Article 42a, faqe 16. Qasur në: <http://www.skupstina.me/images/documents/3.pdf>.

23 Communication from the Commission to the European Parliament and the Council Commission Opinion on Montenegro's application for membership of the European Union (SEC(2010) 1334), Brussels, Nëntor 2010. Qasur në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2010/package/mn\\_opinion\\_2010\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2010/package/mn_opinion_2010_en.pdf).



Parlamenti malazez në vitin **2003** kishte formuar Komisionin për Integrim Evropian, pas **tre vitesh** ai ishte riemëruar duke u quajtur Komision për Marrëdhënie të Jashtme dhe Integrim Evropian.

Konkluzionet që dërgohen në seancë plenare edhe mund të refuzohen dhe kthehen prapë, pastaj komisioni fillon me rimonitorim dhe implementim. Në mandatin e fundit katërvjeçar të parlamentit, janë miratuar gjithsej 509 ligje, gati një e pesta prej të cilave (91) janë miratuar në procedurë urgjente. Kjo gjë nga ana tjetër ka dëmtuar ushtrimin e funksionit të parlamentit në mbikëqyrje të zbatimit të legjislacionit, për shkak të mungesës së resurseve<sup>24</sup>. Komisioni meqë edhe natyrën e ka ndërkombëtare, gjatë aktiviteteve të tij ka edhe vizita në vende tjera, struktura të BE-së dhe në Parlamentin Evropian. Kështu gjatë vitit 2017, ka nënshkruar Protokollin e Bashkëpunimit me Komisionin për Politika të Bashkëpunimit Evropian në senatin italian, i ndjekur me dy protokolle bashkëpunimi me Kroacinë dhe Bullgarinë. Bashkëpunimi me këto vende është i rëndësishëm, pasi të njëjtat janë anëtare të BE-së dhe Mali i Zi si shtet kandidat, mund të përfitojë nga përvojat e tyre. Protokollin për bashkëpunim ndërmjet Komisionit për Integrimin Evropian të Parlamentit të Malit të Zi dhe Komisionit për Çështje Evropiane dhe Mbikëqyrje të Fondeve Evropiane të Asamblesë Kombëtare të Republikës së Bullgarisë, synon forcimin e marrëdhënieve të ngushta dhe miqësore të dy komiteteve, shpall perspektivën evropiane

të Ballkanit Perëndimor, por gjithashtu thekson bashkëpunimin e ndërsjellët parlamentar përmes organizimit të takimeve të rregullta të dy komisioneve dhe shkëmbimit të përvojave profesionale në nivel ekspertësh<sup>25</sup>.

Në përgjithësi, Mali i Zi ka bërë hapa të rëndësishëm drejt integritit, megjithatë ende ka ngecje në disa fusha. Parlamenti por edhe qeveria detyrohen që legjislacionin para së gjithash, ta bashkërendojnë me atë të BE-së. Kthimi i debatit politik në parlament është përgjegjësi e të gjithë aktorëve politikë. Pjesëmarrja aktive dhe konstruktive nga të gjitha palët është e nevojshme për të rritur përgjegjshmërinë parlamentare, mbikëqyrjen e ekzekutivit, kontrollin demokratik dhe cilësi më të mirë të legjislacionit. Duhet shtuar se nuk ka pasur zhvillime të reja në ndjekjen politike dhe gjyqësore të keqpërdorimeve të pretenduara të fondeve publike për qëllime politike<sup>26</sup>.

24 Institut alternativa, "Monitoring and Evaluation of the Rule of Law in Montenegro", nëntor 2016, faqe 10. Qasur në: <http://media.institut-alternativa.org/2017/01/monitoring-and-evaluation-of-rule-of-law-in-montenegro.pdf>.

25 Service of the Parliament of Montenegro, "2018 Performance Report of the Parliament of Montenegro", faqe 33. Qasur në: [http://www.skupstina.me/images/documents/2018\\_Performance\\_Report\\_of\\_the\\_Parliament\\_of\\_Montenegro.pdf](http://www.skupstina.me/images/documents/2018_Performance_Report_of_the_Parliament_of_Montenegro.pdf).

26 Final Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee of the Regions 2019 Communication on EU Enlargement Policy, May 2019, Bruksel, faqe, 13. Qasur në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-communication-on-eu-enlargement-policy\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-communication-on-eu-enlargement-policy_en.pdf).

## 4. Zbatimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Kosovës përmes mbikëqyrjes post-legislative

### 4.1 Korniza ligjore

Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve është lënë në përgjegjësi të komisioneve parlamentare (neni 73), duke përcaktuar autorizime për të gjitha komisionet, që brenda fushës së përgjegjësisë të tyre, të bëjnë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve<sup>27</sup>. Komisionet në kuadër të fushëveprimtarisë së tyre duhet të trajtojnë edhe efektin e ligjeve, me theks te zbatimi i tyre duke përfshirë edhe dhënien e propozimeve konkrete për rritjen e efektshmërisë. Të gjitha raportet e komisioneve parlamentare mbi mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve duhet të votohen në seancë plenare. Një aspekt i rëndësishëm që parashihet me Rregulloren e Punës së Kuvendit, është ai i raportimit të ministrave përkatës pranë komisioneve funksionale në lidhje me zbatimin e ligjeve, së paku një herë në vit. Mirëpo, kjo dispozitë e rregullores ka mbetur vetëm në letër, pasi asnjëherë nuk zbatohet nga ministrat, dhe as komisionet parlamentare nuk e ngritin si çështje në mbledhjet plenare. Kjo gjë parashihet edhe në rregullore, ku thuhet se *“Nëse ministria nuk raporton ose nëse raportimi i saj konsiderohet jo i plotë, me kërkesë të komisionit çështja hyn në rendin e ditës së mbledhjes tjetër plenare”*<sup>28</sup>. Një raportim i tillë vjetor në mbledhjet plenare të kuvendit është paraparë edhe për komisionet, të cilat obligohen që të raportojnë me shkrim dhe me gojë një herë në vit.

Kushtetuta e Kosovës, në kuadër të formës së qeverisjes dhe ndarjes së pushtetit, ka përcaktuar edhe detyrimet e qeverisë për zbatimin e ligjeve dhe nga ana tjetër të kuvendit që ta ushtrojë kontrollin

parlamentar ndaj ekzekutivit<sup>29</sup>. Tutje, në kuadër të kompetencave të kësaj të fundit, të parapara në nenin 93 të Kushtetutës së Kosovës, thuhet se, *“Qeveria merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve”*<sup>30</sup>. Nga këto dispozita kushtetuese, mund të kuptohet rëndësia që hartuesit e saj i kanë dhënë zbatimit të ligjeve dhe akteve të tjera juridike që janë në funksion të zbatimit të tyre, por edhe të vetë kontrollit parlamentar ndaj ekzekutivit, si mjet i domosdoshëm për t’u siguruar zbatimin e mirë të ligjeve.

Përkundër që dispozitat ligjore për mbikëqyrjen parlamentare në zbatimin e ligjeve parashihen në dy prej akteve më të rëndësishme, Kushtetutën e Kosovës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, janë të pamjaftueshme për të garantuar mbikëqyrje efektive. Kuvendi i Kosovës nuk ka nxjerr akte të tjera, qoftë ndonjë rregullore të veçantë apo udhëzues për t’i listuar parimet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, format e mbikëqyrjes apo edhe të metodologjisë që do të ndihmonin komisionet në forcimin e rolit të tyre mbikëqyrës. Po ashtu, do duhej të rregullohej edhe thirrja në përgjegjësi politike e bartësve të funksioneve nëse të njëjtit nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre të përcaktuara me ligj. Në kuadër të doracakut “Funksioni mbikëqyrës i komisioneve parlamentare”, i botuar në vitin 2012 nga kuvendi, një kapitull prej dhjetë faqesh i është dedikuar vetëm mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve.

27 Rregullore e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010.

28 Po aty, neni 73 pika 4.

29 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni, pika 4.

30 Po aty, neni 93, pika 4.

## 4.2 Ushtrimi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nga kuvendi

Komisionet parlamentare në fillim të çdo të viti miratojnë planet e tyre të punës. Në këto plane përfshihen edhe aktivitetet mbikëqyrëse në përgjithësi, duke mos përfshirë edhe ligjet të cilat do të mbikëqyren në aspekt të zbatimit të tyre. Me qëllim të menaxhimit më të mirë të kohës dhe aktiviteteve, komisionet mund të formojnë grupe punuese, si për hartim dhe shqyrtim të projektligjeve ashtu edhe për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve. Nga praktika e deritashme, këto grupe punuese përbëhen nga tre deri në pesë anëtarë dhe të njëjtit i caktohen edhe afatet kohore për përfundimin e procesit mbikëqyrës dhe përgatitjes së raportit.

Grupet punuese të cilat ngarkohen për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit hartojnë planin e veprimit ku planifikohen aktivitetet që do të ndërmerren, siç mund të jenë: organizimi i vizitave në terren, organizimi i dëgjimeve publike, zhvillimi i hulumtimeve, konsultimet me OJQ-të dhe grupe të tjera të interesit, identifikimi dhe shqyrtimi i akteve nënligjore (legjislacioni sekondar) të cilit duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë. Përmes vlerësimit të akteve nënligjore, duhet të përcaktohet se<sup>31</sup>:

1. A janë miratuar aktet nënligjore ashtu siç është paraparë me ligj?
2. Cilat janë efektet e akteve nënligjore?
  - a. A është arritur qëllimi i përcaktuar nga legjislacioni primar?
  - b. Nëse jo, cilat janë arsytet?

Vlerësimi i akteve nënligjore bëhet përmes krahasimit të dispozitave të tyre me ato të ligjit në fuqi nga i cili edhe kanë derivuar, pra për të vlerësuar se a janë në përputhje të plotë apo kanë kundërthënie. Në shumë raste, institucionet ekzekutive kanë miratuar akte nënligjore që kanë tejkaluar autorizimet e tyre të përcaktuara me ligj. Mospërputhjet e identifikuar

ndërmjet akteve nënligjore dhe ligjit paraqesin edhe fazën e parë të problemeve në zbatim. Aktet nënligjore mund të jenë në formë të udhëzimeve administrative, urdhëresave, rregulloreve, vendimeve apo udhërrëfyesve.

Procesi i zbatimit të aktiviteteve mbikëqyrëse kalon nëpër disa faza, që sipas doracakut të kuvendit<sup>32</sup> duhet të kalojë nëpër katër sosh:

- **Faza e parë:** identifikimi i obligimeve që parasheh ligji për zbatuesit dhe vlerësimi i përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin;
- **Faza e dytë:** organizimi i vizitave mbikëqyrëse në terren;
- **Faza e tretë:** raportimi i ministrit apo zyrtarit përgjegjës në mbledhje të komisionit, organizimi i dëgjimit mbikëqyrës, përgatitja e raportit me rekomandime nga grupi punës për mbikëqyrje, shqyrtimi i raportit me rekomandime në komision dhe shqyrtimi i raportit me rekomandime në seancë plenare të kuvendit;
- **Faza e katërt:** raportimi i ministrit apo zyrtarit përgjegjës në komision për zbatimin e rekomandimeve të miratuara në seancë plenare në afatin e përcaktuar nga vetë kuvendi.

31 Udhërrëfyes për vlerësimin ex-post të legjislacioni në Republikën e Kosovës, Prishtinë, 2014, faqe 13. Qasur në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Udherrefyesi\\_per\\_vleresimin\\_ex-post\\_te\\_legjislacioni\\_ne\\_Republiken\\_e\\_Ko....pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Udherrefyesi_per_vleresimin_ex-post_te_legjislacioni_ne_Republiken_e_Ko....pdf).

32 Kuvendi i Kosovës, doracak "Funkcioni Mbikëqyrës i Komisioneve Parlamentare", Prishtinë 2012.

**FIGURA 1.** Skema e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit

FAZA

# 01

- › Hartimi i Planit të Veprimit
- › Identifikimi i obligimeve që parasheh ligji për zbatuesit
- › Vlerësimi i përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin

FAZA

# 02

- › Organizimi i vizitave mbikëqyrëse në terren

FAZA

# 03

- › Raportimi i Ministrit apo zyrtarit përgjegjës në mbledhje të Komisionit
- › Organizimi i dëgjimit mbikëqyrës
- › Përgatitja e raportit me rekomandime
- › Shqyrtimi i raportit me rekomandime në Komision
- › Shqyrtimi i raportit me rekomandime në seancë plenare

FAZA

# 04

- › Raportimi i Ministrit apo zyrtarit në Komision për zbatimin e rekomandimeve të miratuara në seancë plenare pas afatit të përcaktuar nga Kuvendi

Pas përfundimit të aktiviteteve mbikëqyrëse dhe grumbullimit të të gjitha informatave të nevojshme, grupi punues harton edhe draftin e parë të raportit, i cili diskutohet dhe përpunohet deri sa të merr formën përfundimtare. Raporti miratohet fillimisht nga grupi punues, dhe pastaj dërgohet për shqyrtim në mbledhje të rregullt të komisionit.

Në shtojcat e doracakut<sup>33</sup> është ofruar një model i raportit mbikëqyrës të komisioneve. Në këtë model kërkohet që raporti i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit të përmbajë këto elemente:

- hyrjen;
- qëllimin e mbikëqyrjes së ligjit;
- përshkrimin e aktiviteteve të grupit punues;
- përshkrimin e problemeve të identifikuara në zbatimin e ligjit;
- rekomandimet për zbatuesit e ligjit;
- shtojcën me materialet përcjellëse.

Drafti i raportit i cili përgatitet nga grupi punues i dërgohet komisionit për shqyrtim dhe miratim. Pa miratimin e komisionit dokumenti nuk mund të quhet raport, por vetëm draft. Komisioni e shqyrton dokumentin në njërën nga mbledhjet e tij, ku të gjithë anëtarët përfshirë ata që nuk kanë qenë pjesë e grupit punues, kanë të drejtë të propozojnë ndryshime apo plotësime. Propozimet duhet të votohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të komisionit, si dhe votimi për raportin në tërësi. Me këtë rast, komisioni e përcjell raportin në kryesi të kuvendit, të cilës i rekomandohet që ta procedojë për shqyrtim në seancë plenare.

Kryesia e kuvendit e ka për obligim që ta vendosë shqyrtimin e raportit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve në rend të ditës në njërën nga seancat plenare. Në këtë seancë plenare duhet të jetë i pranishëm edhe ministri përgjegjës për zbatimin e ligjit. Zakonisht gjetjet kryesore të raportit dhe rekomandimet prezantohen para deputetëve nga kryesuesi i grupit punues. Më pas, shefat e grupeve parlamentare paraqesin qëndrimet e grupeve të tyre lidhur me të gjeturat e raportit. Gjatë shqyrtimit

të raportit në seancë, fjalën mund ta marrin edhe deputetët tjerë të cilët mund të japin qëndrime dhe propozime. Pas përfundimit të diskutimeve, raporti me rekomandime hidhet në votim me të gjitha vërejtjet miratohet me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm. Raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe rekomandimet e dhëna nga kuvendi, paraqesin detyrim për ekzekutivin që në afatin e përcaktuar t'i zbatojë të njëjtat.

Kuvendi nuk duhet të mjaftohet vetëm me miratimin e raportit mbikëqyrës. Pra, duhet të kryhen aktivitete përcjellëse të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve, por edhe të ndërmarrë veprime konkrete për ta ndryshuar ligjin përkatës, në rast se është vlerësuar se pjesë të caktuara të tij janë të pazbatueshme. Ministrat apo zyrtarët përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve duhet të ftohen në raportim në komisionin gjegjës pikërisht lidhur me zbatimin e rekomandimeve. Në rast të moszbatimit të rekomandimeve brenda afateve të parapara dhe pa ndonjë arsye bindëse, komisioni duhet ta ngritë si çështje për diskutim edhe në mbledhjet plenare të kuvendit.

### 4.3 Procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nga qeveria

Vlerësimi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nuk është vetëm kompetencë e Kuvendit të Kosovës, por hise të tillë ka edhe qeveria. Përderisa, vlerësimi nga kuvendi është ushtrim i funksionit mbikëqyrës, rol ky i përcaktuar me kushtetutë, vlerësimi nga qeveria është më shumë proces vetëvlerësimi ndaj politikave të saj dhe rezultateve të arritura. Për këtë qëllim, qeveria ka miratuar një Udhërrëfyes për Vlerësimin Ex-post të Legjislacionit në Republikën e Kosovës<sup>34</sup>. Krahas miratimit të këtij udhërrëfyesi, ekzekutivi përmes këtij akti nënligjor obligon ministrinë që ta kryejnë analizën e vlerësimit ex-post siç ilustron në udhërrëfyes. Për ta koordinuar punën e vlerësimit ex-post për ligjet e të gjitha ministrive, sekretari i Zyrës së Kryeministrit ishte ngarkuar të themelonte grupin

33 Po aty.

34 Qeveria e Republikës së Kosovës, Udhërrëfyes për Vlerësimin Ex-post të Legjislacionit në Republikën e Kosovës, vendimi nr. 03/38 i datës 15.07.2014.

mbikëqyrës me përfaqësuesit e departamenteve ligjore të ministrive të linjës. Brenda gjashtëmujorit të parë pas hyrjes në fuqi të udhërrëfyesit, ishte paraparë që të identifikohen deri në dy ligje për vlerësim bazë.

Në këtë udhërrëfyes, definicioni i vlerësimit ex-post është përcaktuar si mundësi e administratës publike që të mbledhë të dhëna:

- se si një akt juridik është zbatuar;
- nëse legjislacioni ka arritur qëllimet e parapara;
- nëse legjislacioni është kosto-efektiv; dhe
- për gjetjen e arsyeve të mundshme që kanë rezultuar në vështirësi/efekte të padëshiruara, etj.

Mbledhja e këtyre informatave ka për qëllim që t'u shërbejë organeve propozuese si dhe qeverisë në përgjithësi për të vendosur nëse legjislacioni i vlerësuar përmes vlerësimit ex-post duhet të ndryshohet apo zëvendësohet me dispozita të reja.

Përderisa qëllimi kryesor i vlerësimit ex-post është:

- t'u ndihmojë politikëbërësve dhe zbatuesve të dispozitave ligjore (veçanërisht ministrive dhe administratës publike), për të vlerësuar nëse korniza ligjore aplikohet në mënyrën e duhur nga zbatuesit (administrata publike, publiku i gjerë, autoritetet lokale, bizneset); dhe
- të vlerësojë nëse qëllimet fillestare dhe objektivat janë arritur.

Në këtë udhërrëfyes është përcaktuar edhe metodologjia e vlerësimit ex-post të legjislacionit që duhet të kalojë nëpër pesë hapa kryesorë:

- **Hapi 1:** Nëse legjislacioni duhet të vlerësohet? Në këtë fazë jepen disa prej kriterëve të cilat duhet të zbatohen për të përzgjedhur se cilat ligje duhet t'i nënshtrohen vlerësimit post-legjislativ. Prioritet i jepet ligjeve të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave themelore apo të reformave.

- **Hapi 2:** Cili është afati kohor për vlerësim? Përgjithësisht vlerësimi ex-post rekomandohet të bëhet brenda një apo dy vitesh pas fillimit të zbatimit të ligjit, pra pasi që ligji të ketë krijuar efekt.

- **Hapi 3:** Çka duhet vlerësuar/cili është fushëveprimi i vlerësimit? Në këtë fazë të vlerësimit jepen disa udhëzime që të ndihmojnë për t'u përcaktuar, se a duhet të vlerësohet ligji në tërësi apo vetëm disa dispozita ligjore, apo që të vlerësohen disa ligje që rregullojnë një tematikë, siç mund të jenë ligjet që rregullojnë shëndetin publik.

- **Hapi 4:** Kush janë zbatuesit? Zbatimi i dispozitave ligjore përfshinë një numër të gjerë të zbatuesve, që mund të jenë aktorë administrativ apo përdorues të fundit të ligjit, si qytetarët, bizneset, etj.

- **Hapi 5:** Cilat janë burimet e informatave dhe të dhënat e nevojshme për vlerësim ex-post. Identifikimi i burimeve të informacionit nga ministrinë e linjës është tejet i rëndësishëm për të marrë të dhëna të mjaftueshme për çështjet e zbatimit të ligjit. Në këtë fazë të vlerësimit përcaktohet me kujdes se çfarë të dhënash duhet të mbledhen për të dhënë matje të besueshme, përcaktimi i personave përgjegjës për mbledhjen e të dhënave, afati kohor, formati i ruajtjes së tyre, verifikimi, etj.

Nga viti 2016 deri në vitin 2019, qeveria, respektivisht Zyra e Kryeministrit dhe ministrinë, kanë mbikëqyruar zbatimin e dhjetë ligjeve. Ministria e Punëve të Brendshme ka qenë më aktive në këtë drejtim, duke mbikëqyruar zbatimin e katër ligjeve nga dhjetë sa kanë qenë gjithsej (shih shtojcën 3 për të parë listën e ligjeve të monitoruara). Për vitin 2020, janë paraparë 12 ligje në programin për vlerësim ex-post të legjislacionit.

FIGURA 2. Numri i ligjeve të mbikëqyruara nga qeveria sipas viteve



#### 4.4 Sfidat e Kuvendit në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve

Komisionet parlamentare në vazhdimësi kanë ngecur në zbatimin e Planeve të tyre të Punës, në veçanti sa i përket monitorimit të zbatimit të ligjeve. Kurse Kuvendi i Kosovës në përgjithësi është kritikuar për mosushtim të rolit të vet mbikëqyrës ndaj ekzekutivit.


Që nga viti 2008 e deri më tani, Kuvendi i Kosovës ka miratuar 84 raporte të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve<sup>35</sup>. Viti më produktiv është 2015-ta, kur Kuvendi kishte arritur të mbikëqyrë dhe miratojë 16 raporte të monitorimit të zbatimit të ligjeve. Kurse dy vitet e fundit, 2019-ta dhe 2020-ta, nuk kanë qenë aspak produktive për kuvendin. Në vitin 2019, përkundër që komisionet parlamentare kanë kryer monitorimin e zbatimit të gjashtë ligjeve dhe kanë miratuar në komisione raportet, dështimet e Kuvendit për të siguruar kuorumin e nevojshëm për të mbajtur mbledhje gjatë legjislaturës së gjashtë dhe për shkak të shpërndarjes së kuvendit, këto raporte nuk kishin arritur të miratohen në seanca plenare. Mosmiratimi i këtyre raporteve ka zhvlerësuar punën e komisioneve dhe si të tilla, pa një miratim nga Kuvendi, raportet nuk kanë fuqi juridike. As në vitin 2020, kuvendi nuk ka të miratuar asnjë raport të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Legjislatura e shtatë është duke u sfiduar në shumë drejtime. Fillimisht ishte vonesa në formimin e qeverisë së re

pas zgjedhjeve, që u bë tek në fillim të muajit shkurt. Pastaj mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë Kurti në fund të muajit mars e deri në zgjedhjen e Qeverisë Hoti në fillim të muajit qershor, u bën shkaktare që kuvendit t'i pamundësohet ushtrimi i kompetencave që ka. E sfida më e madhe ishte pandemia COVID-19, që vështirësojë gjithçka, e sigurisht edhe punën e kuvendit.

35 KDI, raporti "Kuvendi që (s')mund të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve", korrik 2019. Qasur në: [http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2019/07/Brief\\_FINAL\\_per-pdf.pdf](http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2019/07/Brief_FINAL_per-pdf.pdf)



**FIGURA 3.** Numri i raporteve të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës 2008-2020



Sa u përket sfidave me të cilat përballen komisionet parlamentare në ushtrimin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve që ndikojnë në performancë jo të kënaqshme, kanë të bëjnë me mungesën e kapaciteteve për të trajtuar të gjitha çështjet me të cilat ngarkohen komisionet. Pjesa më e madhe e kohës së komisioneve i dedikohet shqyrtimit të projektligjeve të cilat dërgohen në kuvend nga ana e ekzekutivit, por edhe të raportimeve të ministrave dhe udhëheqësve të institucioneve tjera të cilat janë nën mbikëqyrjen e Kuvendit të Kosovës. Pra, shqyrtimi i raporteve të tyre vjetore, si të punës ashtu edhe financiare, konsumon një pjesë të madhe të kohës së kuvendit. Kështu që, pak kohë i dedikohet mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Për më tepër, komisionet parlamentare, respektivisht deputetët dhe stafi mbështetës, jo gjithmonë kanë ekspertizën e nevojshme për të kryer aktivitete mbikëqyrëse për tema të caktuara. Përdorimi i buxhetit të komisioneve nuk bëhet për të angazhuar ekspert të jashtëm që do të ndihmonin komisionin në kryerjen e hulumtimeve dhe analizave në terren. Kjo bënë që shumë prej raporteve të jenë sipërfaqësore, të cilat nuk mund t'i identifikojnë saktë problemet kryesore të moszbatimit të ligjit dhe efektet e tij në praktikë. Si pasojë, raportet nuk përmbajnë rekomandime konkrete që do të shpinin në ndryshim të legjislacionit.

Hartimi i raporteve bazohet shumë nga gjetjet që bëhen prej vizitave të grupeve punuese në terren, respektivisht nga intervistat që zhvillohen me zbatuesit e ligjit. Të bazuarit vetëm në këto të gjetura rrezikon prodhimin e raporteve të njëanshme, sidomos nëse ato nuk verifikohen dhe nuk shoqërohen me analiza të tjera statistikore. Rreziku i kësaj është që zbatuesit e ligjit mund të japin vetëm këndvështrimin e tyre, jo edhe situatën reale.

Një aspekt tjetër që ndikon në mosushtrimin e aktiviteteve mbikëqyrëse është edhe raporti kuvend-qeveri. Kjo e fundit ushtron kontroll mbi deputetët e tyre, duke e shndërruar kuvendin vetëm në vulë të miratimit të projektligjeve dhe vendimeve tjera në interes të ekzekutivit, por jo edhe në mbikëqyrës rigoroz dhe filtër të këtyre projektligjeve dhe politikave qeveritare. Raportimi i ministrave në kuvend është sipërfaqësor dhe ata nuk sfidohen nga deputetët, veçanërisht nga ata të koalicionit qeverisës. Po ashtu, qeveria shpërfill rekomandimet dhe rezolutat e kuvendit të cilat kërkojnë marrjen e veprimeve nga vetë ekzekutivi.

Korniza ligjore, respektivisht Rregullorja e Punës së Kuvendit nuk parasheh në mënyrë të detajuar aktivitetet mbikëqyrëse të zbatimit të ligjeve dhe sanksionet ndaj ekzekutivit në rast të shpërfilljes së

rekomandimeve dhe afateve për zbatimin e tyre. Duhet përmendur që mungesa e një metodologjie më të avancuar ka ndikuar negativisht në cilësinë e raporteve.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile të cilat mund të ofrojnë ekspertizë në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nuk është në nivel të kënaqshëm. Ky bashkëpunim është më shumë sporadik sesa i strukturuar. OJQ të ndryshme kanë kryer raporte të tilla me vetiniciativë, dhe kanë identifikuar dispozita të ligjeve të cilat nuk zbatohen apo që prodhojnë efekte të kundërta në raport me objektivat e ligjit. Këto resurse shtesë duhet të konsiderohen dhe merren parasysh nga komisionet parlamentare.

Shpesh është hasur edhe në moskordinim të nivelit qëndror me atë lokal, e që vërehet më shumë tek aspekti i zbatimit të ligjeve. Pasi të miratohen ligjet, komunat nuk kanë informata të mjaftueshme për obligimet e tyre të dala nga ligji i ri. Në këto raste paraqitet një diskrepancë e turbullt mes dy niveleve që pamundëson zbatueshmërinë e ligjit. Nga përvojat dhe rastet e mëparshme, komunat nuk konsultohen në fazat e miratimit të ligjeve, ndonëse ka shumë ligje që prekin fushëveprimtarinë e tyre.

#### 4.5 Analiza e raporteve të PLS-së

Ashtu siç është thënë edhe më sipër në këtë punim, fokusi kryesor i komisioneve parlamentare qëndron te shqyrtimi i projektligjeve, ndërsa monitorimi i zbatimit të ligjeve mbetet në margjina. Katër komisionet e përhershme të Kuvendit të Kosovës, kanë barrën më të madhe në shqyrtimin e projektligjeve pasi ato duhet të japin vlerësimet brenda fushëveprimtarisë së vet për secilin projektligj që shqyrtohet në kuvend. Nga praktika e kaluar, komisionet parlamentare kanë paraparë nga dy ligje për monitorim të zbatimit në Planet e Punës.

Për qëllime të këtij raporti, ne kemi përzgjedhur dy raporte të monitorimit të zbatimit të ligjeve të cilat janë miratuar nga kuvendi. Raportet janë të dy legjislativave të ndryshme, të pestës dhe të gjashtës. Qëllimi i analizës së tyre është të zbërthejë aktivitetet të cilat kryhen nga grupet punuese për të monitoruar

zbatimin e ligjit, dhe të vlerësojë nëse të gjeturat janë të qarta mjaftueshëm për zbatim nga institucionet përgjegjëse.

#### ***Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale***

#### ***Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare Legjislatura e gjashtë, maj 2018***

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, më 24 janar 2018 ka themeluar një grup punues për të mbikëqyrë zbatimin e Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare. Grupi punues ka qenë në përbërje prej katër anëtarëve. Qëllimi kryesor i monitorimit të zbatimit të këtij ligji kishte të bënte me vlerësimin se sa po zbatohet ligji dhe aktet nënligjore nga institucionet përgjegjëse zbatuese, por edhe i efekteve dhe pasojave të moszbatimit të ligjit. Qëllimet e përshkruara në raport janë shumë të përgjithshme duke ta krijuar kështu përshtypjen se grupi punues nuk ka pasur ide të qarta dhe informata paraprake në çështjet në të cilat do të fokusohet dhe ato që kanë vështirësi në zbatim.

Për ta kryer vlerësimin, grupi punues kishte realizuar takime dhe vizita në terren, me qëllim që të grumbullohen të dhëna në lidhje me funksionimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe të vlerësojë nëse qeveria, përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, por edhe komunat, janë duke i përmbushur obligimet që dalin nga ky ligj.

Puna e këtij grupi punues, nga themelimi në janar e deri te publikimi i raportit në maj të vitit 2018, ka zgjatur rreth pesë muaj. Grupi punues është mbështetur edhe nga UNICEF dhe KOMF gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit. Të gjeturat e grupit punues nga vlerësimi i zbatimit të ligjit janë ndarë në dy pjesë: 1) të arriturat dhe 2) problemet e sfidat.

Sa i përket të arriturave, grupi punues ka vlerësuar se përmes ligjit është mundësuar ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare, duke arritur të sigurojë zbatimin e standardeve të këtyre shërbimeve. Po ashtu, përmes këtij ligji vlerësohet se është mundësuar krijimi i mekanizmave koordinues ndërmjet nivelit qëndror dhe lokal, por edhe me



## Të gjeturat e grupit punues nga vlerësimi i zbatimit të ligjit janë ndarë në dy pjesë:

- 1) të arriturat**
- 2) problemet e sfidat.**

agjencitë ndërkombëtare, OJQ-të dhe donatorë të ndryshëm. Grupi punues në këtë raport ka konstatuar edhe se përmes ligjit është mundësuar krijimi i mekanizmave të licencimit të institucioneve dhe profesionistëve të shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe krijimi i mekanizmave mbikëqyrës dhe kontrollues. Nga ky vlerësim i grupit punues i paraqitur në raport, kuptohet që vlerësimi është bërë vetëm sa për të verifikuar nëse janë krijuar këta mekanizma, por që nuk ofrohet asnjë vlerësim për mënyrën e funksionimi të tyre apo të efekteve ashtu siç përshkruhet në qëllimet e raportit.

Përderisa decentralizimi i shërbimeve sociale është renditur te pjesa e të arriturave, pikërisht decentralizimi ishte vlerësuar të jetë edhe pengesa kryesore në zbatimin e ligjit, pasi është bërë pa i kryer të gjitha përgatitjet dhe pa u koordinuar mjaftueshëm me institucionet tjera. Të gjeturat e raportit bijen në kundërshtim me njëra-tjetrën. Në pjesën e të arriturave thuhet se është bërë decentralizimi i shërbimeve, e te pjesa e problemeve dhe sfidave thuhet se procesi i decentralizimit nuk është finalizuar ende. Po ashtu, përfundohet se për të zbatuar decentralizimin siç parashihet me ligj, institucionet duhet të ndërmarrin disa hapa për përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së ofrimit të shërbimeve. Ky përfundim është shumë i përgjithshëm dhe nuk mund t'u hyjë në punë as institucioneve për të bërë përmirësimin e shërbimeve, pasi nuk jep asnjë detaje se cilat

shërbime duhet përmirësuar, ku kanë qenë mangësitë, si duhet të përmirësohen, etj.

Raporti nuk ofron siguri edhe nëse standardet e shërbimeve sociale po zbatohen. Në pjesën e të arriturave thuhet se ligji ka arritur të sigurojë zbatimin e standardeve të duhura të këtyre shërbimeve, kurse te problemet dhe sfidat thuhet se si pasojë e numrit të vogël të stafit, e bënë të vështirë ofrimin e shërbimeve në përputhje me standardet e përcaktuara nga MPMS-ja. Problemet tjera të identifikuar kryesisht kanë të bëjnë me mungesën e buxhetit, numrin e vogël të stafit të QPS-ve, dhe mungesën e infrastrukturës. Nga këto të gjetura, krijohet përshtypja se deri në këto përfundime është konstatuar vetëm nga procesi i takimeve dhe vizitave në terren me zbatuesit e ligjit, që kryesisht paraqesin ankesa të këtyre llojeve.

Përkundër që Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare është ndryshuar dy herë nga kuvendi, komisioni ka rekomanduar sërish hartimin e një ligji të ri i cili ndër të tjera duhet të definojë kompetencat ndërmjet nivelit qendror dhe lokal. Raporti përmban gjithsej 16 rekomandime të cilat përgjithësisht janë shumë të arsyeshme. Mirëpo ekzistojnë dy probleme te rekomandimet e dhëna. E para, nuk përcaktohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre, sidomos për faktin që ka shumë aktorë që janë të përfshirë. E dyta, rekomandimet nuk janë të ndërlidhura me pjesën tjetër të raportit,

nuk përshkruhen si probleme apo sfida të cilat janë identifikuar nga grupi punues gjatë kryerjes së aktiviteteve të monitorimit të zbatimit të ligjit.

***Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport***  
***Ligji për Arsimin Parauniversitar***  
***Legjislatura e pestë, mars 2016***

Përmes Ligjit për Arsimin Parauniversitar rregullohet baza ligjore për arsimin parauniversitar, përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë për institucionet zbatuese të këtij ligji dhe pjesëmarrësit tjerë në arsimin parauniversitar. Ky ligj obligon Ministrinë e Arsimit të nxjerrë akte nënligjore.

Komisioni ka vendosur të bëjë mbikëqyrjen e ligjit më 15 prill 2015, dhe për këtë qëllim ka themeluar grupin punues në përbërje të pesë anëtarëve. Puna e grupit punues është mbështetur nga GIZ, përmes angazhimit të ekspertëve për të kryer procesin e monitorimit të zbatimit të ligjit.

Sikurse në raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenies Sociale për mbikëqyrje të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, qëllimet e monitorimit edhe të këtij ligji janë pothuajse identike, me disa modifikime të vogla. Duket sikur ato janë kopjuar nga ndonjë shabllon i përgatitjes së raporteve. Qëllimet janë për vlerësim të përgjithshëm të zbatimit të ligjit dhe përmbushjes së obligimeve nga institucionet përgjegjëse zbatuese.

Përgjatë procesit të vlerësimit, grupi punues ka kryer disa aktivitete, përfshirë hartimin e një pyetësori për MASHT, identifikimin dhe analizën e përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin, përputhshmërinë e ligjit me ligjet tjera, janë kryer po ashtu disa takime me zyrtarë të MASHT, ministri është ftuar për raportim në komision, janë kryer vizita nëpër institucionet arsimore publike dhe private, si dhe janë organizuar dëgjime publike.

Te pjesa e të gjeturave nga monitorimi i zbatimit të ligjit, në raport janë listuar disa prej rezultateve që ka dhënë ligji, siç janë zbatimi i Kornizës Kurrikulare të Kosovës, dhe licencimi i mësimeve. Pjesa

më e madhe e të gjeturave i dedikohet mangësive të evidentuara, të cilat janë kategorizuar në bazë të neneve të ligjit. Kjo e bën më të lehtë edhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të raportit, por edhe të amendamentimit eventual të ligjit. Raporti përmban 13 rekomandime, të gjitha të adresuara për MASHT.

## 5. Rekomandimet

---

1. Komisionet parlamentare duhet t'i kushtojnë më shumë rëndësi aktiviteteve të monitorimit të zbatimit të ligjeve. Ato duhet ta shtojnë numrin e ligjeve të planifikuara në planet e tyre të punës dhe t'i kryejnë monitorimet sipas afateve të përcaktuara.
2. Kryesia e kuvendit duhet të përcjellë zbatimin e planeve të punës së komisioneve parlamentare në mënyrë periodike, duke kërkuar nga kryetarët e komisioneve t'u përmbahen planifikimeve, në veçanti sa i përket aktiviteteve të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve.
3. Kuvendi duhet të hartojë një udhëzues të monitorimit të zbatimit të ligjeve për nevoja të komisioneve parlamentare. Hartimi i këtij udhëzuesi do të ndikojë në rritjen e cilësisë së raporteve të monitorimit, do të parasheh në mënyrë të detajuar të gjithë fazat e procesit të monitorimit. Krahas udhëzuesit, kuvendi duhet të promovojë parimet ndërkombëtare të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, siç janë ato të hartuara nga WFD.
4. Përgjatë fazës të hulumtimeve dhe analizave të procesit të monitorimit, komisionet parlamentare duhet ta konsiderojnë mundësinë e angazhimit të ekspertëve të jashtëm për të ndihmuar grupet punuese në vlerësimet e tyre.
5. Rekomandimet në raportet e zbatimit të ligjeve duhet të përcaktojnë edhe se cilët janë institucionet përgjegjëses për zbatimin e tyre.
6. Kuvendi duhet të ndryshojë dispozitat në Rregulloren e Punës sa i përket raportimit të ministrive përkatëse për zbatimin e ligjeve pa kërkesë të komisioneve. Kjo dispozitë nuk është duke gjetur zbatim, pasi ministrinë as nuk janë të informuara sa duhet për obligimet që ju dalin nga kjo rregullore, por as komisionet parlamentare nuk bëjnë kërkesë që mosraportimi të hyjë si çështje në rendin e ditës së mbledhjeve plenare. Në vend të kësaj, rregullorja duhet të parasheh obligimet e komisioneve për të kërkuar raporte të shkruara dhe raportime të ministrave në mbledhje të komisioneve për zbatimin e ligjeve, po ashtu të parasheh periodha të caktuara, siç mund të jetë brenda muajit të parë pas fillimit të sesionit vjeshtor të punës së kuvendit.
7. Komisionet parlamentare duhet t'i publikojnë të gjitha raportet e miratuara të monitorimit të zbatimit të ligjeve. Publikimi i raporteve do të mundësojë që OJQ-të dhe mediat, por edhe aktorë tjerë të jenë më të informuar për ngecjet e identifikuara në zbatimin e ligjeve. Ato mund të ndihmojnë në kryerjen e aktiviteteve të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të kuvendit.

# Shtojca 1: Parimet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nga parlamentet të hartuara nga WFD

## MANDATI

- 1) Kuvendi ka përgjegjësi për të monitoruar nëse ligjet e miratuara janë zbatuar ashtu siç janë të destinuara dhe nëse kanë pasur efektet e pritura. Prandaj, mbikëqyrja e zbatimit të ligjit është një mjet i rëndësishëm për rritjen e përgjegjësisë së qeverisë.
- 2) Në mënyrë tipike ekzistojnë tri instrumente të detyrueshme të mandatit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit: sipërmarrja ministrore, dispozitat e rishikimit dhe dispozitat të cilat shfuqizohen pas një periudhe të caktuar.
- 3) Edhe kur nuk bëhet asnjë angazhim detyrues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit gjatë kalimit të projektligjit, kuvendi duhet të jetë në gjendje të ndërmarrë një shqyrtim paslegjislativ për çdo çështje që ai zgjedh.

## QËLLIMI

- 1) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit rishikon të dyja si ligjin në fuqi ashtu edhe ndikimin e tij në shoqëri, duke kontribuar në përmirësimin e vetë ligjit dhe mirëqenies së njerëzve.
- 2) Për të shfrytëzuar kohën dhe burimet në mënyrën më efektive, parlamentit i duhet një proces transparent për të identifikuar pjesët e legjislacionit që janë zgjedhur nga rishikimi i post-legjislativ.
- 3) Për të kuptuar zbatimin dhe ndikimin e legjislacionit, është e dobishme të rishikohet legjislacioni sekondar ose i deleguar në kohën e njëjtë gjatë rishikimit të aktit të parë.
- 4) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit ofron një mundësi për të vlerësuar ndikimin e legjislacionit në çështjet që përfshihen nëpër akte të ndryshme, siç janë çështjet gjinore apo të minoriteteve.

## **PJESËMARRËSIT**

- 1) Kuvendi duhet të marrë në konsideratë nëse përgjegjësia e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit duhet të qëndrojë me komisionin e përhershëm apo me ndonjë organ tjetër të dedikuar. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit duhet të shërbejë si një proces gjithëpërfshirës në të cilën mund të marrin pjesë të gjitha grupet.
- 2) Që kuvendi të kryejë në mënyrë të efektshme mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, duhet të fuqizojë burimet njerëzore duke ua mundësuar atyre të punojnë me sisteme dhe aplikacione të përshtatshme të teknologjisë. Kuvendi mund ta konsiderojë mundësinë për të krijuar një shërbim të specializuar parlamentar ose për të transferuar këtë funksion te një panel i jashtëm i pavarur shqyrtues që duhet raportuar në parlament.
- 3) Angazhimi publik në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit mundëson qasjen në burime shtesë të informacionit, rrit besimin e gjetjeve dhe të publikut në institucionet demokratike.

## **PROCESI**

- 1) Përfshirja e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit në rregullat parlamentare të procedurave kontribuon në gjenerim të qartësisë, qëllimit dhe burimeve të aktiviteteve të post-legjislacionit.
- 2) Proceset e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit shmangin një përsëritje të thjeshtë të argumenteve të politikave nga koha kur vihen në diskutim meritat e ligjit.
- 3) Efekti i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit kërkon qasje dhe kohë të plotë në informacionin qeveritar, gjithashtu edhe pikëpamjeve të një game më të gjerë të palëve të interesuar, përfshirë organizatat e shoqërisë civile.
- 4) Kuvendi duhet të ketë procese për të siguruar gjetjet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, në mënyrë që kur është e nevojshme, ndryshimet në legjislacion dhe politikë të bëhen në kohën e duhur.

## **KOHA**

- 1) Mbikëqyrja e zbatimit të një ligji në përgjithësi duhet të zhvillohet të paktën tre vjet pas miratimit të tij.

## Shtojca 2: Lista e raporteve ex-post të legjislacionit të miratuar dhe akteve që janë në Program për vlerësim për vitin 2020

### Lista e raporteve ex-post të legjislacionit të miratuara

Nr.	EMËRTIMI I LIGJIT APO AKTIT NËNLIGJOR TË CILIT I ËSHTË BËRË VLERËSIMI EX-POST	Organi propozues – ministria	Afati kohor
1.	Raporti për Vlerësimin ex-post të Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore	MD	2016
2.	Raporti për Vlerësimin ex-post të Ligjit 04/L-076 për Policinë	MPB	2017
3.	Raporti për Vlerësimin ex-post të Ligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile	MPB	2017
4.	Raporti për Vlerësimin ex-post të Ligjit nr. 04/L-048 për Tregti me Jashtë	MTI	2017
5.	Raporti për Vlerësimin ex-post të Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore	ABGj/ZKM	2018
6.	Raporti për Vlerësimin Ex-post të Ligjit Nr.04/L-074 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	MBPZhr	2018
7.	Raporti Për vlerësimin ex-post të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale	MAPL	2018
8.	Raporti për Vlerësimin ex-post të Ligjit Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës	MPB	2018
9.	Raporti për vlerësimin ex-post të Ligjit Nr. 03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit	MPB	2019
10.	Raporti për vlerësimin ex-post të Ligjit Nr. 05/L- 064 për Patent Shoferi	MIT	2019



**Lista me aktet të cilat janë në  
Programin për vlerësim  
ex-post të legjislacionit për vitin 2020**

<b>Nr.</b>	<b>EMËRTIMI I LIGJIT APO AKTIT NËNLIGJOR QË DO T'I BËHET VLERËSIMI EX-POST</b>	<b>Organi propozues – ministria</b>	<b>Afati kohor</b>
1.	Ligji për Avokatin e Popullit	MD	30.07.2020
2.	Ligji për Avokatinë	MD	30.09. 2020
3.	U.A QRK 10/2017 për Listën e Treguesve për Identifikimin e Viktimave të Trafikimit me Njerëz	MD	30.11. 2020
4.	Ligjit nr. 04/L-022 për Përdorim Civil të Eksplozive	MPB	15.10.2020.
5.	Ligji nr.2004/44 për Zejtari;	MTI	30.10. 2020
6.	Ligji për Maturën Shtetërore	MAShTI	30.11.2020
7.	Udhëzimin Administrativ 03/2017 për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike	MSh	15.11.2020
8.	Ligji Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit hapësinor dhe Ndërtimit;	MEA	30.09.2020
9.	Ligji për Bujqësi Organike	MBPZHR	30.11.2020
10.	Ligji nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor	MI	30.10.2020
11.	Ligji për Zgjedhjet Lokale	MPL	28.09.2020
12.	Ligji Nr.04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës	MPMS	30.11.2020

## Bibliografia

---

1. Westminster Foundation for Democracy (WTF), Post-Legislative Scrutiny in the Americas, Ecuador, mars 2019. Qasur në: <http://www.parlamericas.org/uploads/documents/2019-03-06%20draft%20Comparative%20Study%20on%20PLS%20in%20Americas%20-%20English%20Version.pdf>.
2. Westminster Foundation for Democracy (WTF), Principles of Post-Legislative Scrutiny by Parliaments, London, janar 2018. Qasur në: <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2018/07/Principles-of-Post-Legislative-Scrutiny-by-Parliaments.pdf>.
3. Westminster Foundation for Democracy (WTF), Post-Legislative Scrutiny, Guide for Parliaments, London, nëntor 2017. Qasur në: [https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2018/07/WFD\\_Manual-on-Post-Legislative-Scrutiny.pdf](https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2018/07/WFD_Manual-on-Post-Legislative-Scrutiny.pdf).
4. Westminster Foundation for Democracy (WTF), "Post-Legislative Scrutiny Comparative study of practices of Post-Legislative Scrutiny in selected parliaments and the rationale for its place in democracy assistance", Londër, 2017. Qasur në: <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2018/07/Comparative-Study-PLS-WEB.pdf>.
5. De Vrieze, F., & Fitsilis, F., "Parliamentary Oversight of Sustainable Development Goals and the Application of Post-Legislative Scrutiny Principles", Wroxtton, 2019. Qasur në: [https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=3429635](https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3429635).
6. Regulation (EU) No 2016/794 on Europol. Qasur në: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/583126/IPOL\\_STU\(2017\)583126\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/583126/IPOL_STU(2017)583126_EN.pdf).
7. Westminster Foundation for Democracy (WTF), Franklin De Vrieze, "Post-Legislative Scrutiny in Europe", Londër 2020. Qasur në: [https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/02/WFD\\_DeVrieze\\_2020\\_PLSinEurope.pdf](https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/02/WFD_DeVrieze_2020_PLSinEurope.pdf).
8. Official Journal of the European Union. "Treaty of Lisbon amandamenting the Treaty on European Union and the Treaty establishing the European Community" (2007/C 306/01), Article 8 C. Qasur në: [http://publications.europa.eu/resource/ceilar/688a7a98-3110-4ffe-a6b3-8972d8445325.0007.01/DOC\\_19](http://publications.europa.eu/resource/ceilar/688a7a98-3110-4ffe-a6b3-8972d8445325.0007.01/DOC_19).
9. UNDP Moldova. "Role of Parliament in European Integration", qershor 2011. Qasur në: <https://agora-parl.org/sites/default/files/UNDP%20Moldova%20Final%20Report%20on%20Parliament%20and%20European%20Integration.pdf>
10. The Constitution of the Republic of Lithuania. Qasur në: <https://www.lrs.lt/home/Konstitucija/Constitution.htm>.
11. Seimas of the Republic of Lithuania, 1994, Vilnius. Qasur në: [https://publicofficialsfinancialdisclosure.worldbank.org/sites/fdl/files/assets/law-library-files/Lithuania\\_Seimas%20Statute\\_1994\\_amended%20through%20November%202009\\_EN.pdf](https://publicofficialsfinancialdisclosure.worldbank.org/sites/fdl/files/assets/law-library-files/Lithuania_Seimas%20Statute_1994_amended%20through%20November%202009_EN.pdf).
12. Official site of Parliament of Lithuania, "The Seimas and the EU". Qasur në: [https://www.lrs.lt/sip/portal.show?p\\_r=35664&p\\_k=2&p\\_t=250052](https://www.lrs.lt/sip/portal.show?p_r=35664&p_k=2&p_t=250052)
13. Jurkynas, M, "Lithuania- Life in PostCommunist

- Eastern Europe after EU Membership: Happy Ever After?", Oxon, Routledge, 2012.
14. Robert Schuman Centre for Advanced Studies, EU Member States' Consultation with Civil Society on European Policy Matters, Florence, October 2011. Qasur në: [https://cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/19357/eudo\\_report\\_2011\\_04.pdf?sequence=1](https://cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/19357/eudo_report_2011_04.pdf?sequence=1).
  15. Public Relations Unit of the Communications Department of the Seimas of the Republic of Lithuania, "Seimas (parliament) of the Republic of Lithuania", Vilnius. Qasur më: [https://www3.lrs.lt/leidiniai/Seimas\\_kn\\_en.pdf](https://www3.lrs.lt/leidiniai/Seimas_kn_en.pdf).
  16. "Seimas, Scrutiny of the Eu Affairs in the Seimas of the Republic of Lithuania".
  17. UNDP Moldova. "Role of Parliament in European Integration". Qasur në: <https://agora-parl.org/sites/default/files/UNDP%20Moldova%20Final%20Report%20on%20Parliament%20and%20European%20Integration.pdf>.
  18. Official site of the Parliament of the Republic of Moldova - Standing Committees, Committee on Foreign Policy and European Integration.
  19. UNDP Moldova, "Functional and Institutional Analysis Findings and recommendations" April 2016.
  20. Official site of the Parliament of Montenegro: Assembly in the process of Montenegro's accession to the EU.
  21. Legislative Committee of the Parliament of Montenegro: Rules of Procedure, Committee on European Integration Article 42a.
  22. Communication from the Commission to the European Parliament and the Council Commission Opinion on Montenegro's application for membership of the European Union {SEC(2010) 1334}, Brussels, November 2010.
  23. Institut alternativa, "Monitoring and Evaluation of the Rule of Law in Montenegro", nëntor 2016, faqe 10. Qasur në: <http://media.institut-alternativa.org/2017/01/monitoring-and-evaluation-of-rule-of-law-in-montenegro.pdf>.
  24. Service of the Parliament of Montenegro, "2018 Performance Report of the Parliament of Montenegro". Qasur në: [http://www.skupstina.me/images/documents/2018\\_Performance\\_Report\\_of\\_the\\_Parliament\\_of\\_Montenegro.pdf](http://www.skupstina.me/images/documents/2018_Performance_Report_of_the_Parliament_of_Montenegro.pdf).
  25. Final Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee of the Regions 2019 Communication on EU Enlargement Policy, May 2019, Bruksel. Qasur në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-communication-on-eu-enlargement-policy\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-communication-on-eu-enlargement-policy_en.pdf).
  26. Rregullore e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës..
  27. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
  28. Udhërrëfyes për vlerësimin ex-post të legjislacionit në Republikën e Kosovës, Prishtinë, 2014. Qasur në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Udherrefyesi\\_per\\_vleresimin\\_ex-post\\_te\\_legjislacionit\\_ne\\_Republiken\\_e\\_Ko....pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Udherrefyesi_per_vleresimin_ex-post_te_legjislacionit_ne_Republiken_e_Ko....pdf).
  29. Kuvendi i Kosovës, Doracak "Funkzioni Mbikëqyrës i Komisioneve Parlamentare", Prishtinë 2012.
  30. KDI. Kuvendi që (s')mund të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve. Korrik 2019. Qasur në: [http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2019/07/Brief\\_FINAL\\_per-pdf.pdf](http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2019/07/Brief_FINAL_per-pdf.pdf)

